

## Përfaqësues Shitjesh në Showroom

**EPPC Albania** kërkon një **Përfaqësues Shitjesh në Showroom**, për klientin e saj, një kompani lider në sektorin e tregëtise dhe shpërndarjes së materialeve elektrike dhe të ndriçimit.

### Përgjegjësitë kryesore:

- Informon dhe orienton klientët ose përfaqësuesit e tyre në procesin e planifikimit dhe zgjedhjes së produkteve dhe ndjek në vazhdimësi procesin e shitjes;
- Krijon dhe ruan marrëdhënie të mira dhe afatgjata me klientët e industrisë (arkitektë, inxhinierë, instalatorë, elektrikistë, etj.) dhe ruan komunikim të mirë edhe me palët e tjera të përfshira (furnitorë, stafi i magazines, etj.);
- Përdor programin e kompanisë për të gjuruar ecurinë e çdo porosie, procesin e punëve të kryera dhe listën e klientëve me të cilët ka ndërvepruar;
- Suporton agjentët e terrenit në ndjekjen e problematikave të ndryshme me klientët gjatë procesit të shitjeve;
- Mirëmban ambientin e Showroom-it;
- Raporton periodikisht rreth aktivitetit të vet të shitjes.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare (përbejnë avantazh degët inxhinierike);
- Përbën avantazh eksperiencë e mëparshme e punës në pozicione/industri të ngjashme;
- Aftësi për të lexuar si duhet modele të ndryshme planimetrish në mënyrë që të sigurohet përshtatshmëria midis produkteve të porositura dhe kërkesave të klientit;
- Aftësi shumë të mira shitëse, komunikimi dhe prezantimi;
- Përbën avantazh njohja e gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht).

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun: <https://aplikim.eppc.al>.

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.